


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite
Ministry of Labour and Social Welfare

KOMUNA E GJAKOVËS

Kompania Rexhionale
e Mbeturinae "ÇABRATI"
SH. A. GJAKOVË

Marrëveshje Bashkëpunimi

Për realizimin e projektit "Punë publike në komunën e Gjakovës"

Ndërmjet:

Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale
(më tutje: MPMS)

Komunës së Gjakovës

dhe

Kompanisë Regjionale të Mbeturinae "Çabрати" Sh. A. Gjakovë

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit ndërmjet MPMS-së, Komunës së Gjakovës dhe Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabrat" Sh. A. Gjakovë, është realizimi i projektit të punëve publike në komunën e Gjakovës, ku do të angazhohen pesëmbëdhjetë (15) punëkërkuar dhe të papunë për një periudhë kohore tre (3) muaj.
2. Punëtorët e angazhuar, nën menaxhimin e kompanisë, do të angazhohen në pastrimin e qytetit, lagjeve urbane, pastrimin e infrastrukturës rrugore, varrezave, lumenjve, hapësirave të objekteve publike shkollore, parqeve si dhe në pastrimin e hapësirave tjera në pronësi publike.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo marrëveshje përcakton përgjegjësitë e palëve, MPMS-së, Komunës së Gjakovës dhe Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabrat" Sh. A. Gjakovë, në realizimin e projektit për punësimin sezonal të punëkërkuarve dhe të papunë në punë publike në Komunën e Gjakovës.
2. Në kuadër të projektit për punësimin sezonal të punëkërkuarve në punë publike në komunën e Gjakovës, do të angazhohen gjithsej pesëmbëdhjetë (15) punëkërkuar dhe të papunë të cilët janë të regjistruar si punëkërkuar në Zyrën e Punësimit në Gjakovë për një periudhë kohore tre (3) muaj.

Neni 4

Bazat e bashkëpunimit

Bazat e bashkëpunimit për realizimin e kësaj marrëveshje është legjislacioni i zbatueshëm në Republikën e Kosovës nga fusha e tregut të punës.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e MPMS-së janë si vijon:
 - 1.1. Të siguroj mjetet financiare në shumën 11.250.00 euro për kompensimin e punëtorëve të angazhuar në projekt;
 - 1.2. Të paguaj punëtorët e angazhuar me pagë mujore në shumën prej dyqindpesëdhjetë (250) euro për muaj;

- 1.3. Të përcaktoj dinamikën e aktiviteteve për realizimin e projektit dhe në bashkëpunim me Komunën e Rahovecit dhe me Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Çabrat" Sh. A. Gjakovë, të përcaktoj lokacionin se ku duhet të angazhohen punëtorët;
- 1.4. Se bashku me Komunën e Gjakovës të rekrutojë dhe përzgjedh punëtorët si dhe të përgatisë kontratat e punës për punëtorët e angazhuar në projekt;
- 1.5. Të rekrutojë dhe përzgjedh punëtorët nga lista e punëkërkuesve të regjistruar në Zyrën e Punësimit në Gjakovë, me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi nga Komuna e Gjakovës dhe Kompania Regjionale të Mbeturinave "Çabrat" Sh. A. Gjakovë.
- 1.6. Të angazhojë punëkërkuesit nga ato vendbanime mundësisht sa më afër lokacioneve apo vend punishteve ku do të punojnë punëtorët;
- 1.7. Të angazhojë mundësisht sa më shumë punëkërkues të cilët janë shfrytëzues të asistencës sociale kategoria e II-të, të cilat gjatë kohës sa janë të angazhuar në projekt do tu ndërpritet asistenca sociale; dhe,
- 1.8. Sipas rrethanave edhe mundësive të angazhohen edhe punëkërkues nga komuniteti RAE dhe femra.

Neni 6

Të drejtat dhe përgjegjësit e Komunës së Gjakovës

1. Të drejtat dhe përgjegjësit e Komunës së Rahovecit sipas kësaj marrëveshje janë:
 - 1.1. Bashkëpunimi me MPMS/APRK dhe Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabrat" Sh. A. Gjakovë, drejtë realizimit të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit;
 - 1.2. Caktimi i një përfaqësuesi i cili do të bashkëpunojë me Zyrën përkatëse të Punësimit rreth selektimit të punëkërkuesve për angazhim sipas këtij memorandumi të Mirëkuptimit;
 - 1.3. Përbushë të gjitha detyrimet ligjore për realizimin e kësaj mase punë publike konform Ligjit 05/L-077, rregullores 01/2018 pa përjashtuar dispozitat tjera ligjore nga fusha e punësimit dhe aftësimi profesional të ndërlidhura me fushën e bashkëpunimit.

Neni 7

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabrat" Sh. A. Gjakovë

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e kompanisë janë:
 - 1.1. Të organizojë stafin dhe makinerinë shtesë për pastrim, në emër të përbushjes së detyrimeve sipas projektit të cekur në këtë marrëveshje;

- 1.2. Të përcaktoj dinamikën e aktiviteteve për realizimin e projektit dhe në bashkëpunim me Zyrën e Punësimit në Gjakovë të përcaktoj lokacionet/vendpunishtet se ku duhet të angazhohen punëtorët;
- 1.3. Të caktoj një përfaqësues nga kompania që do të marrë pjesë në procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes të punëkërkuësve të regjistruar në Zyrën e Punësimit në Gjakovë;
- 1.4. Të mbikëqyrë realizimin e projektit dhe të caktoj një përfaqësues nga kompania që do të përcjell angazhimin e punëtorëve mbi baza ditore në lokacione dhe vendpunishte;
- 1.5. Të njoftoj dhe informoj Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Zyrën e Punësimit në Gjakovë lidhur me listat e vijueshmërisë së punëtorëve mbi baza ditore;
- 1.6. Të njoftoj dhe informoj Drejtorinë për Shërbime Publike Zyrën e Punësimit në Gjakovë lidhur me realizimin e projektit në përgjithësi si dhe sfidat e paraqitura;
- 1.7. Ti mundësoj Këshilltarëve nga Zyra e Punësimit në Gjakovë qasje në monitorimin e realizimit të projektit.

Neni 8

Mos pajtimet dhe paqartësitë

1. Secila palë nënshkruese e marrëveshjes mund ta ndërprerë marrëveshjen brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit me shkrim, nëse pala tjetër nuk është në gjendje apo në ndonjë mënyrë pengohet në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi të veta sipas marrëveshjes, duke vënë në rrezik arritjen e objektivave të projektit, me kusht që palët janë konsultuar, por pa sukses në përpjekje për të eliminuar pengesën.
2. Pas njoftimit për ndërprerje, siç përcaktohen në paragrafin e 1 të këtij neni, palët menjëherë marrin hapat e nevojshëm për të finalizuar aktivitetet e tyre sipas marrëveshjes, duke e bërë këtë sa më shpejtë dhe në mënyrë të organizuar me qëllim të minimizimit të humbjeve dhe shpenzimeve shtesë.

Neni 9

Zgjidhjet e mosmarrëveshjeve

1. Në rast se në mes të palëve të kësaj Marrëveshjeje, paraqiten paqartësi, mos pajtime apo për ndonjë arsye tjetër, do të zgjidhen përmes bisedimeve.
2. Nëse tentativat për zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve nuk kanë sukses, secila nga palët mund t'a ndërpresë këtë Marrëveshje. Njoftimi për ndërprerjen e Marrëveshjes duhet t'i dërgohet palës tjetër me shkrim, së paku një muaj para ndërprerjes efektive të saj.

Neni 10

Modifikimi i marrëveshjes apo shkëputja e saj

1. Kjo Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të modifikohet apo të shfuqizohet në mënyrë automatike me hyrjen në fuqi të ndonjë ligji, fushëveprimi i të cilit prek ndonjë nga pikat e kësaj marrëveshjeje, apo aktet tjera nënligjore dispozitat e të cilave janë në kundërshtim me këtë Marrëveshje.
2. Çdo ndryshim eventual i kësaj marrëveshjeje do të shtohet si aneks dhe hynë në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit e institucioneve zbatuese të kësaj marrëveshjes.
3. Secila nga palët mund të tërhiqet brenda tridhjetë (30) ditëve pas paralajmërimit me shkrim.
4. Kohë e paralajmërimit do të merret data e pranimit të letrës paralajmëruese



Neni 11

Hyrja në Fuqi


1. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet më datën ____/____/ 2018, në Prishtinë, Republika e Kosovës, në tri (3) ekzemplar origjinale, nga një për së cilën palë nënshkruese.
2. Marrëveshja do të fillojë së zbatuari nga data **01 Gusht 2018** dhe do të zgjasë deri me datën **31 Tetor 2018** me mundësi të vazhdimit nëse palët pajtohen.

PALET NËNSHKRUESE

Për: Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale
z. Izedin Bytyqi, Sekretari i Përgjithshëm



Për: KRM "ÇABRATI" SH.A Gjakovë
z. Kujtim Qela, u.d. Ekzekutiv



Prishtinë, Korrik 2018